



## Breaking News:



15/10/2025

# Policia E Shtetit/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Identikiti"

Policia e Shtetit/Finalizohet operacioni policor i koduar "Identikiti"

Operacioni, nga shërbimet e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë.

Lokalizohet në Tiranë dhe vihet në pranga, një shtetas me rrezikshmëri shoqërore të lartë, i implikuar në një sërë veprimtarish kriminale.

Më datë 29 gusht 2025, i armatosur dhe i maskuar me skafandër motomjeti, ai tentoi të vidhte në një argjendari në Shkodër.

Në momentin e ndalimit, 29-vjeçari kishte me vete sasi Cannabisi

Në banesën që ai kishte marrë me qira, në Tiranë, me qëllim fshehjen, mbante pa leje, 1 armë zjarri pistoletë.

Gjithashtu, në këtë banesë u gjetën 2 maska silikoni, municion luftarak, 3 pajisje për grirjen e lëndës narkotike, si dhe 550 dollarë (kartëmonedha false).

Arrestohen për përkrahje të 29-vjeçarit, 2 shtetasit që lëviznin me të, në automjet, në momentin e kapjes.

Në kuadër të operacionit "Identikiti", shërbimet e DFPO-së, në bashkëpunim me shërbimet e DVP Shkodër, dhe të Komisarariatit të Policisë nr 4, Tiranë, bazuar në informacionet e marra, kapën në lagjen "5 Maji", Tiranë, duke lëvizur me një automjet tip "Audi", dhe vunë në pranga shtetasit F. B. alias F. B., 29 vjeç, Xh. D., 21 vjeç dhe E. E., 19 vjeç.

Drejtuiesi i automjetit, shtetas F. B. alias F. B. u vu në pranga sepse Gjykata e Shkodrës më datë 30.09.2025, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vjedhja me armë", mbetur në tentativë, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit". Nga hetimet dyshohet se ky shtetas është autor i tentativës për të vjedhur në një argjendari, në lagjen "Vasil Shanto", ku hyri më datë 29.08.2025, i armatosur dhe i maskuar me skafandër motomjeti.

Gjatë kontrollit fizik në momentin e arrestimit, atij iu gjet dhe iu sekuestrua një sasi lëndë narkotike Cannabis Sativa. Më tej, gjatë kontrollit në banesën që kishte marrë me qira, në Tiranë, u gjetën 1 armë zjarri pistoletë, 2 maska, municion luftarak, 3 pajisje për grirjen e lëndës narkotike, 550 dollarë (kartëmonedha false), shumë lekësh dhe aksesore, të cilat u sekuestruan së bashku me 2 automjete dhe me 1 celular.

Ndërkaq, në vijim të veprimeve procedurale, u arrestuan në flagrancë shtetasit Xh. D. dhe E. E., për veprën penale "Përkrahja e autorit të krimit", pasi ishin pasagjerë në automjetin e të kërkuarit, në momentin e ndalimit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



## Komisariati Dixhital



GET IT ON

# Google Play



Download on the  
**App Store**

Arkiva

Select Month

Linge

- Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Dibër/Finalizohet operacioni policor i koduar “Skaneri”

Tentoi të kontrabandonte mallra të ndryshme, në Shqipëri, kapet nga shërbimet e Policisë Kufitare Kakavije dhe vihet në pranga 58-vjeçari ►